



Honorarkonsulat der Republik Albanien

Rellinghauser Str. 22 | 45128 Essen

Curriculum Vitae

Znj. Anduena Stephan

Konsulle e Nderit e Republikës së Shqipërisë

Landi i Rinit të Veriut dhe Vestfalisë, Gjermani





Datëlindja: 17 August 1969
Statusi Familjar: Martuar, 2 fëmijë
Nënshtetësia: Gjermane

Anduena Stephan ka një eksperiencë prej më shumë se 25 vjetësh në mjedise të ndryshme sociale dhe ekonomike në vende të ndryshme të Europës. E specializuar në sektorin e akuizicioneve, konçesioneve, manaxhimit të transaksioneve, riorganizimeve të ndërmarrjeve si dhe zhvillimit të produkteve të reja, ajo ka marrë pjesë aktivisht në një numër të madh projektsh në më shumë se 30 vende të botës. Ajo ka punuar intensivisht si për sektorin privat ashtu dhe për sektorin publik sidomos në fushën e bashkëpunimeve publiko-private qofshin këto në formën e investimeve, konçesioneve afatgjata, shitjeve të ndërmarrjeve apo konsulencës së mirëfilltë. Eksperienca e saj e punës shtrihet nga fusha e infrastrukturës në atë të energjisë, edukimit, shëndetit, shërbimeve, tregtisë si dhe në sektorin jo-fitimprurës. Ajo ka jetuar dhe punuar në Shqipëri, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani.

Përveç aktiviteteve që lidhen me fushën e saj profesionale, Znj Stephan është angazhuar prej vitesh dhe në aktivitete jo-fitimprurëse dhe honorifike në fushat e promovimit të arsimit dhe edukimit, kulturës dhe integritit të diasporës shqiptare.

Znj. Stephan ka bashkëpunuar intensivisht me shumë institucione dhe kompani gjermane, ndërkombëtare dhe shqiptare ndër të cilat mund të përmendim: EBRD Business Advisory Services (Shërbime Konsulencë Financiare), DEG - German Investment and Development Bank (Banka Gjermane e Investimeve dhe Zhvillimit), GIZ (më parë e njohur si GTZ) – Institucioni Gjerman për Bashkëpunimin Ndërkombëtar, CIM – (Qendra Ndërkombëtare për Migracionin), IOM – (Organizata Ndërkombëtare e Migracionit), Dhomat e Tregtisë të Essenit dhe Tiranës, NRW. International – Agjensia e Promovimit të Investimeve të Landit të Rinit të Veriut dhe Vestfalisë, HOCHTIEF Airport GmbH (Investime dhe Konçesione në Aeroporte), Zürich International Airport AG (Investime në Infrastrukturë), Dräger AG (Futje e Teknologjisë së Fundit në Tregun e Sigurisë në Punë), Alpine Energie AG (Energji), SAG Energy Solutions (Energji) GmbH, European Hydro Energy Group Denmark (Energji e Rinovueshme), HOCHTIEF Concessions AG (Konçesione në Autostrada), RWE AG (Investime në Fushën e Energjisë), Soptim Business Consult sbc (Shërbime Konsulencë në Fushën e Energjisë), IPRO PLAN (Planifikim dhe Mbikqyrje në Ndërtim), Verbund GmbH (Energji), Thyssen Krupp AG (Paisje për Infrastrukturën), ICTS BV (Siguria në Aeroporte dhe Infrastrukturë), OSRAM SHPK (Produkte Konsumi dhe Distribucion), MEDFAU SHPK (Siemens Medical Solutions) (Projekte dhe Produkte në Fushën e Mjeksisë), Independent College (Arsim), etc.



Anëtarësitë në Shoqata:

- Përfaqësuese e Përhershme e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës në Landin e Rinit të Veriut dhe Vestfalisë www.cci.al
- Presidente e IDEAL – Integrative Deutsch Albanische Gesellschaft e.V., Essen, Germany, Shoqata Integrative Gjermano Shqiptare, www.i-de.al.org
- Anëtare Bordi e Shoqatës Ekonomike Gjermano Shqiptare (DAW), Berlin, Germany, www.daw-wirtschaftsgesellschaft.de
- Iniciatore dhe Themeluese e Dhomës së Tregtisë Shqipëri Gjermani – DIHA dhe Anëtare e Bordit deri në Maj, 2011, Tiranë, Shqipëri, www.dih-al.com
- Lektore e Asociuar e Universitetit të New York, Tiranë, Shqipëri, www.unyt.edu.al

Arsimi:

Kolegjet/Universitetet

1995 - 1996	City University Business School, London Specializimi: Biznes Ndërkombëtar dhe Strategji Diploma Pasuniversitare: Master në Administrim Biznesi
1987 – 1991	Universiteti i Tiranës, Histori dhe Filologji Diploma: Dipl.-Filologji, Anglisht/Pedagogji

Trajnime dhe Kurse të Tjera:

Shkurt 2006	“Planifikimi dhe Biznesi” kurs i specializuar për planifikim kariere dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, Essen, Gjermani
Tetor 2005	“Unë si personalitet Drejtues” , kurs i specializuar për nivelin e lartë të manaxhimit mbi mënyrën e drejtimit ekzekutiv në ndërmarrje, Abtenau, Austri, mbajtur nga Bachler Team, Austri
Mars 2004	HOCHTIEF Holding Forum për Manaxher Ekzekutiv , Seminar vlerësues për manaxhere ekzekutive brenda HOCHTIEF Holding, Wessel, Gjermani
Shtator 2002	Seminar financiar mbi bashkimet dhe përthithjet e kompanive , seminar intensiv mbi mekanizmat e funksionimit të bashkimeve dhe përthithjeve të kompanive organizuar nga Euromoney Training EMEA, Amsterdam, Hollandë



Gjuhët

- Shqip Gjuha amtare
- Gjermanisht Niveli i gjuhës amtare
- Anglisht: Niveli i gjuhës amtare
- Italisht: njohuri shumë e mire në të folur, të kuptuar dhe të lexuar
- Spanjisht: njohuri e mirë në të folur, të lexuar dhe të kuptuar
- Frengjisht: njohuri bazë në të lexuar dhe kuptuar
- Greek: njohuri bazë në komunikim

Eksperienca Profesionale

Nga: 2006 Deri: në vazhdim

Punëdhënësi: Sprint! Energy Consulting GmbH Essen, Gjermani / SPRINT! Marketing and Management Consulting, Tiranë, Shqipëri

Pozicionet: **Drejtorë për Projektet Ndërkombëtare dhe Partnere Ekzekutive** përgjegjëse për zhvillimin e projekteve të reja dhe manaxhimin e tyre si në Evropën Perëndimore ashtu dhe me kompani nga Evropa Juglindore, përfshirë Shqipërinë. Sektorët kryesorë janë:

- **Akuizicioni dhe Manaxhimi i Transaksioneve** në të cilën përfshihen studimet e tregut në industri dhe sisteme rregullatore të ndryshme, studime fizibiliteti, strategji për rritjen e tregut, auditim i dokumentacionit të tenderimeve, përgatitja e ofertave, përgatitja e planeve të biznesit dhe financimit, gjetja e partnerëve strategjikë, përgatitja e strategjive të komunikimit.
- **Ristrukturimi i Biznesit** në të cilën përfshihen zhvillimi i produkteve të reja, diversifikimi i biznesit, përgatitja e investimeve, ristrukturimet organizative, vlerësimet e sistemit rregullator dhe ligjor, përgatitja e standarteve të cilësisë dhe procedurave përkatëse.
- **Manaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Kërkimi i Personelit Ekzekutiv** në të cilën përfshihen auditimet e brendshme të personelit, planet e zhvillimit dhe trajnimit të nivelit ekzekutiv të kompanisë dhe kryerja e këtyre trajnimeve, manaxhimi i burimeve njerëzore si shërbim i jashtëm, gjetja dhe seleksionimi dhe punësimi i stafit ekzekutiv.
- **Marketing dhe Komunikim** në të cilën përfshihen zhvillimi i planeve të marketingut, strategjitë për publicitetin dhe prezantimin mediaviziv të kompanive në sektorin privat dhe publik.



Nga: 2004 Një: 2006

Punëdhënësi: Tirana Airport Partners LLC

Pozicioni: Drejtore e Parë Ekzekutive e Tirana Airport Partners me përgjegjësinë për drejtimin e të gjithë koncesionit 20 vjeçar për ndërtim, operim, manaxhim të Aeroportit të Tiranës me një xhiro vjetore prej 18 million Euro në vit dhe një program investimi në fazën e parë prej 50 million Euro dhe një fuqi punëtore prej 184 punonjësish me kohë të plotë.

Nga: 2002 Një: 2004

Punëdhënësi: HOCHTIEF AirPort GmbH

Pozicioni: Drejtore Projekti për Shqipëri dhe Koncesionin e Aeroportit të Tiranës me përgjegjësinë për drejtimin dhe manaxhimin e të gjithë projektit përfshirë të gjitha etapat e tenderimit, nënshkrimit të marrëveshjeve, nënkontraktimeve dhe marrjes përsipër të operacioneve duke drejtuar një ekip prej gati 150 personash nga 7 vende të botës.

Nga: 1999 Një: 2001

Punëdhënësi: HOCHTIEF AirPort GmbH

Pozicioni: Senior Manager në departamentin e Planifikimit dhe Financimit të Biznesit me përgjegjësinë për drejtimin dhe strukturimin e investimeve të ndryshme në aeroporte dhe autostrada në shkallë botërore.

Nga: 1998 Një: 1999

Punëdhënësi: HOCHTIEF AirPort GmbH

Pozicioni: Senior Manager në departamentin e Akuizicioneve dhe Optimimit të Portofolit të Investimeve me përgjegjësinë për drejtimin e investimeve të reja në infrastrukturë, riorganizimin e investimeve të kryera dhe ndërmarrjeve të përthithura dhe zhvillimin e produkteve dhe tregjeve të reja.

Nga: 1997 Një: 1998

Punëdhënësi: HOCHTIEF Project Development GmbH, Germany

Pozicioni: Analiste biznesi në departamentin e investimeve në infrastrukturë, aeroporte, porte, autostrada.



Nga: 1994 Në: 1997

Punëdhënësi: BHF Bank, London, City University Research Centre, London, Children in Crisis, NGO-UK based, British Home Office, London, UK

Pozicioni: Konsulente e jashtme për produktet bankare për Banken BHF, proceset e ndryshimeve organizative në Evropën qendrore dhe lindore përfshirë Shqipëri dhe Qendren Kërkimore të Universtit të Londres si dhe konsulente e jashtme e shoqatave jo-fitimprurëse siç është shoqata e Dukeshës së York-ut, Fëmijët në Krizë.

Nga: 1994 Në: 1991

Punëdhënësi: Deminex Albania, GmbH, Essen, Germany

Pozicionet: Administratore Biznesi për degën e Shqipërisë së kompanisë së naftës Gjermane, e para kompani konçesionare në Shqipëri e vitit 1991 që u mor me eksplorimet e naftës në det.

Nga: 1988 Në: 1990

Punëdhënësi: Albturnist, Shqipëri, Radio Tirana, Emisioni i valëve të Shkurtra në Anglisht

Pozicionet: Shoqëruese e parë e grupeve turistike perëndimore dhe folëse e Radio Tirana për emisionet e lajmeve në gjuhën angleze.

Eksperienca Akademike

Nga: 2007 Në: 2012

Punëdhënësi: University of New York/Empire State College, USA, Tirana

Pozicioni: Lektore e Jashtme për lëndët e mëposhtme:

- “Manaxhimi ndërkombëtar i burimeve njerëzore”
- “Manaxhimi dhe Marketingu strategjik”,
- “Drejtimi Manaxherial” dhe
- “Manaxhimi i biznesit të vogël dhe të mesëm”



Konferencat

Nëntor 2013	Organizatore dhe Moderatore e Ditës së Parë të Dialogut “Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia Perëndimore të ftuar në Landin e Rinit të Veriut dhe Vestfalisë”, Essen, Gjermani organizuar nga Shoqata Integrative Gjermano Shqiptare IDEAL mbi temën e “Rolit të Diasporës në krijimin e urave të integritit dhe komunikimit”
Nëntor 2012	Referente kryesore e Konferencës “Programi i Transferimit të Aftësive dhe Njohurive nga Diaspora në Vendet Amë dhe Kontributi i Tyre në Zhvillim” Sarajevë, Bosnia dhe Hercegovina, organizuar nga IOM – Organizata Botërore e Migracionit mbi temën e “Efektiviteti i Përfshirjes së Diasporës Shqiptare – Kthimi Virtual”
Mars 2010	Referente Kryesore e Konferencës “Një treg në Rritje për Investime dhe Tregti” Mynih, Gjermani, organizuar nga Dhoma e Tregtisë e Mynihut dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Tiranës mbi temën e “Pajtimi i kulturave të ndryshme në të mirë të investimeve”.
Dhjetor 2010	Referente Kryesore në Konferencën “Diaspora Shqiptare dhe Integrimi i saj ne Ekonominë Shqiptare – Strategjia e Fitimit të Trurit” Tiranë, Shqipëri organizuar nga IOM-Organizata Botërore e Migracionit mbi Temën e “Integritit të Inteligjencës Shqiptare të Diasporës në Zhvillimin e Vendit”.
Qershor 2009	Moderatore Kryesore e Panelit dhe Referente në Konferencën “Perspektivat e Rritjes – Infrastrukturë – Tregëti dhe Shkëmbim” Hamburg, Gjermani organizuar nga DAW – Deutsch-Albanisch Wirtschaftsgesellschaft dhe Qyteti i Hamburgut mbi temën e mundësive të investimit në Shqipëri në kuadrin e marrjes së statusit të Kandidatit për në BE të Shqipërisë.
Tetor 2008	Moderatore Kryesore e Panelit dhe Referente në Konferencën Sektoriale – Energji, Ndërtim, Mjedisi” Tiranë, Shqipëri organizuar nga DAW – Shoqata Ekonomike Gjermano Shqiptare në Berlin mbi temën “Atraktiviteti i Shqipërisë për Investitorët në Energji, Ndërtim dhe Manaxhim Mjedisi”.
Shtator 2008	Referente Kryesore dhe Organizatore në Konferencën Gjermano Shqiptare “Biznes i Gjeneruar nga Gratë”, Tiranë, Shqipëri organizuar



nga GTZ mbi temën “Gratë e Biznesit në Shqipëri dhe Gjermani dhe Vendorsja e rrjeteve të Kooperimit”

- Nëntor 2007 **Referente Kryesore në Konferencën “Shqipëria – Një vend për Investime”**, Berlin, Gjermani, organizuar nga DAW – Shoqata Ekonomike Gjermano Shqiptare në Berlin mbi temën “Investimet në Shqipëri – Sa Tërheqëse është Shqipëria”
- Shtator 2007 **Referente Kryesore në Konferencën “Samiti i Biznesit dhe Investimeve në Shqipëri”**, Tiranë, Shqipëri, organizuar nga Konventa Evropiane për Ekonominë mbi temën “Investoni në Shqipëri – 2007”
- Prill 2007 **Referente Kryesore në Konferencën “Samiti i Biznesit dhe Investimeve në Kosovë”**, Prishtinë, Kosovë, organizuar nga Konventa Evropiane për Ekonominë mbi temën “Investimet e Huaja Direkte, Privatizimet dhe Mundësi Biznesi në Evropën Jug - Lindore”
- Nëntor 2005 **Referente Kryesore në Konferencën “Samiti i 8-ë i Vendeve të Evropës Qendrore” Transporti Ajror**, mbi eksperiencën në privatizimet e bëra në Evropën Qendrore, Bratislava, Slovakia
- Qershor 2005 **Referente Kryesore në Konferencën dhe Anëtare e Delegacionit në “Impakti i Investimeve në Evropën Jug - Lindore”**, takim Ndër-Ministerial organizuar nga PWC, OECD, Austria dhe Bullgaria mbi Temën e Investimeve më të Suksesshme në Rajon, ku projekti i Aeroportit dhe Drejtuesja e Projektit morën çmimin “Investitori më i Suksesshem i Vitit për Vendin”